DEPARTAMENTI E ARSIMIT SHUMEGJUHESH
Zyra e Kurikulës dhe Mësimdhënies
440 North Broad Street Suite 251
Filadelfia, PA 19130
(215) 400-4240

Prindit ose Kujdestarit të _____,

Në përputhje me synimet edukative të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias dhe Zyrës së të Drejtave Civile të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë, Kreu 22, Kapitulli 4, Paragrafi 4.26 të Kërkesave të Kurikulës, kërkohet që Drejtoria Arsimore të ofrojë një program për çdo nxënës, që ka aftësi të kufizuara të Anglishtes (LEP) ose është nxënës që mëson gjuhën Angleze (ELL). Kjo rregullore kërkon:

Çdo drejtori arsimore do të ofrojë program për çdo nxënës, gjuha amëtare e të cilit nuk është Anglishtja, për të lehtësuar arritjet e nxënësit në gjuhën angleze në nivelin i Aftë (Proficient) dhe të standardeve akademike sipas § 4.12 (që lidhen me standardet akademike përkatëse). Programet sipas këtij paragrafi, do të përfshijnë mësimdhënien e duhur dygjuhësore-dykulturore ose Anglisht si gjuhë e dytë (ESL).

Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka zhvilluar Programin "Anglishtja për Folësit e Gjuhëve të tjera" (ESOL) për nxënësit që mësojnë Anglishten si gjuhë të dytë (ELL). Qëllimi i këtij programi është të aftësojë nxënësit me nivele të kufizuara të Anglishtes, të bëhen kompetent në dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim në gjuhën Angleze.

Fëmija juaj u testua për të parë nivelin e tij/saj në gjuhën Angleze përmes testit WIDA-ACCESS të shtetit të Pensilvanisë. Me nivelin e pikëve prej_____fëmija juaj është i vlefshëm dhe do të regjistrohet në programin ESOL.

Nxënësit në programin ESOL do të marrin mësim në gjuhën Angleze dhe mësues të ESOL do të ndihmojnë nxënësit në përvetësimin e standardeve mësimore të kërkuara nga shteti i Pensilvanisë. Fëmija juaj do të qëndrojë në programin ESOL derisa ai/ajo të jetë i aftë për t'u larguar nga ky program. (shiko më tej kriteret e daljes nga programi).

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi telefononi në _____.

Sinqerisht,

_____ _____
Drejtori i shkollës/*Principal* Shkolla/*School*

_____
Mësuesi i ESOL/*ESOL Teacher*

_____
Date/Data

Kriteret e Daljes nga Programi ESOL

Kriteret e Daljes nga programi ESOL,si kërkesa shtetërore të paraqitura më poshtë për Nxënësit që Mësojnë Anglisht (ELL) ,pasqyrojnë evidenca të vlefshme dhe bindëse të aftësive të një nxënësi që Mëson Anglisht ,për të dalë nga programi mësimor i gjuhës Angleze. Në mënyrë që të përmbushen kriteret e daljes nga programi arsimor ELL i kërkuar nga Shteti, shkollat duhet të përdorin të dyja kriteret e kërkuara të daljes nga programi, si më poshtë.
Për më tepër, shkollat duhet të sigurojnë që nxënësit të përmbushin një nga 2 kriteret shtesë të dhëna më poshtë, që nxënësi të dalë nga programi mësimor i gjuhës Angleze:

Kriteret e Kërkuara për Dalje nga programi:

1. Marrja e pikëve 5.0-niveli I Aftë (Bridging) në testin e Vlerësimit të Kuptimit dhe Komunikimit të Anglishtes (ACCESS). Ky vlerësim kryhet çdo vit për nxënësit që mësojnë Anglisht për të përcaktuar nivelin e aftësisë sipas Standardeve të Përcaktimit të Aftësisë në Gjuhën Angleze të shtetit të Pensilvanisë për nxënësit ELL në fushat e Dëgjimit, të Folurit (Komunikimit), Leximit dhe Shkrimit. Pikët në nivelin I Aftë llogariten si kombinim i pikëve në të gjitha fushat e vlerësimt.
2.Marrja e vlerësimit Bazë (Basic) në testin vjetor të Vlerësimit të Sistemit të shkollës së shtetit të Pensilvanisë.

****FAKTORE TE VEÇANTE:***

• *Për nxënësit e transferuar nga një shtet tjetër, rezultatet e nxënësit në vlerësimet akademike të shtetit tjetër mund të merren në konsideratë, kur niveli i arritjeve akademike është i krahasueshëm me atë të nivelit Bazë (Basic) të testit PSSA.*
• Nxënësit, të cilët janë në një klasë që nuk kryet tesit *PSSA: Duhet të përmbushen secilat nga kriteret e mëposhtëme.*

Kritere shtesë për daljen nga programi:

1. Nota përfundimtare C ose më lart në lëndët (Matematikë, Art Gjuhësor, Shkencë dhe Studime Shoqërore)

2. Marrja e pikëve në vlerësimet e bëra nga drejtoria, që janë të krahasueshme me nivelin bazë në PSSA. (TerraNova- Lexim dhe Matematikë, 40%+)

Shënim: Ekipet IEP duhet të përcaktojnë nëse nxënësit ELLs ,që janë edhe nxënës të arsimit special ,duhet të vendosin për daljen e tyre nga programi ESOL përpara përmbushjes së Kriterit të Daljes sipas pikësynimeve të IEP-së së tyre.

Me daljen e nxënësit nga programi, duhet të dërgohen në shtëpi letrat e Njoftimit të Prindërve për Daljen e Nxënësit nga programi, për t'u bërë të ditur se fëmija i tyre ka dalë nga programi, Procesi i daljes mund të ndodhë në çdo kohë gjatë vitit shkollor.
Përsa i përket mandatit të Kreut III (Title III mandate), të gjithë nxënësit që kanë dalë nga programi, duhet të monitorohen nga mësuesit ESOL për dy vjet.